



Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 11 të Ligjit Nr.03/L-139, për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, nenin 2 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-205 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-139, si dhe nenin 44 dhe nenit 53 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën Administrative, me datë 16.03.2023 merr këtë:

VENDIM PËRFUNDIMTAR

1. **Ndryshohet dhe plotësohet** Vendimi Përfundimtar me numër 01-464-13500, datë 26.05.2017, ashtu që vendimi do të jetë:

APROVOHET Pjesërisht kërkesa e subjektit kërkuar, për shpronësim për interesin publik të pronave të paluajtshme, të cilat ndodhen në zonën kadastrale të Komunës së Gjakovës, Z.K. Gjakovë qytet, qëllimi për të cilin shpronësohen ka të bëjë me mbrojtjen e monumentit kulturor dhe historik "Kulla e Sylejman Vokshit", për paluajtshmëritë të cilat sipas tabelës i bashkëngjiten këtij Vendimi dhe për të cilat do të bëhet kompensimi pronarëve.

- 1.1. Pjesë e shpronësimit janë vetëm parcelat (me objekte) nr. 1100-0 dhe 1099-1
2. Pas nënshkrimit të këtij Vendimi Përfundimtar brenda 5 (pesë) ditëve të punës, njoftohen pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen.
3. Kundër këtij Vendimi apo cilësdo pjesë të tij, palët kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda (30) tridhjetë ditësh kalendarike në Gjykatën kompetente, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit. Këtë të drejtë e kanë subjektit kërkuar, secili person që është pronar në pronë e paluajtshme, e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht a është i identifikuar apo jo në tabelën e bashkëngjitur këtij Vendimi.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e Komunës së Gjakovës.
5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, **shfuqizohet** Vendimi për pezullimin e Vendimit Përfundimtar me numër 01 nr. 464/01-20431, datës 24.05.2019
6. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh më të madh në Kosovë.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit të Komunës së Gjakovës
- Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës
- Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
- Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
- Arkivit.


Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës





REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL GJAKOVË
SKUPSTINA OPSTINE DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



SHPRONËSIMI TE KULLA E SYLEMAN VOKSHIT

| Nr. Rendor | Numri parcelës | Pronari | Lloji i shfrytëzimit të pronës/Klasa e kualitetit | Sipërfaqja e përgjithshme [m ²] | Sipërfaqja e mbetur [m ²] | Sipërfaqja për shpronësim [m ²] | Zona Kadastrale | |
|---|----------------|--|---|---|---------------------------------------|---|------------------|--|
| 1 | 1099-1 | 8/192 Safete Gojani 32/192 Dren Gojani 32/192 Hamëz Gojani 32/192 Shandere Gojani 38/192 Haki Gojani 50/192 Lulzim Gojani 7/64 Valbone Kalaveshi 8/64 Myzaqete Kalaveshi 14/64 Reshat Kalaveshi 7/64 Hekuran Kalaveshi 14/64 Enver Kalaveshi | Oborr , Shtëpi- Ndertese | 532 | 0 | 532 | Gjakove Qytet | |
| 2 | 1100-0 | 14/64 Naser Kalaveshi | Oborr , Shtëpi- Ndertese | 679 | 0 | 679 | Gjakove Qytet | |
| SIPERFAQJA TOTALE PER SHPRONESIM | | | | | | | 1211 | |